

VENDIM
Nr. 58, datë 29.5.2013

MBI SHTYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE TË BALANCIMIT

(Ndryshuar me vendimin nr. 71, datë 7.7.2013)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.5.2013, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për një ndryshim në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 33, datë 10.4.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshohet si më poshtë:

- *Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012 do t'i shtrijë efektet deri më 31 dhjetor 2013.*

2. Ngarkohet Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani